



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

# Raport Konsultativ

Shqyrtimi i Shtatë i Tarifave të Energjisë Elektrike

**SHTE7 (2013-2017)**

Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

## DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE për të marrë komente eventuale nga palët e interes. Dokumenti nuk paraqet vendim të ZRRE-së.

**19 tetor 2012**

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Hyrje</b> .....	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Komente të Përgjithshme</b> .....	<b>2</b>
<b>3</b>	<b>Vlerësimi i Kostove të Divizionit të Gjenerimit dhe të Minierave të KEK-ut</b> .....	<b>3</b>
3.1	Shpenzimet Operative të Minierave .....	3
3.2	Shpenzimet Operative të Gjenerimit.....	3
3.3	Shpenzimet Kapitale të Minierave .....	4
3.4	Shpenzimet Kapitale të Gjenerimit .....	4
<b>4</b>	<b>Vlerësimi i Shpenzimeve Kapitale të Divizionit të OSSH-së së KEK-ut</b> .....	<b>4</b>
4.1	Propozimet e shpenzimeve kapitale të Divizionit të OSSH-së së KEK-ut: .....	4
4.2	Kostot e KEK-ut për njësi .....	5
4.3	Modelimet e shpenzimeve që kanë të bëjnë me ngarkesën dhe të atyre që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën.....	5
<b>5</b>	<b>Shpenzimet Operative të OSSH-së së KEK-ut</b> .....	<b>6</b>
<b>6</b>	<b>Kostot e FPEE-së</b> .....	<b>6</b>
<b>7</b>	<b>Hapat e mëtutjeshëm</b> .....	<b>6</b>

### 1 Hyrje

Më 8 qershor 2012 ZRRE kishte filluar Shqyrtimin e Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE7) i cili për herë të parë do të mundësojë përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për një periudhë shumë-vjeçare. Sipas Ligjit, këto të Hyra Maksimale të Lejuara duhen të jenë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e arsyeshme operative dhe kostot e kapitalit që kanë të bëjnë me aktivitetet e rregulluara. Për të përcaktuar shumën e të Hyrave të nevojshme, ZRRE duhet të vlerësojë parashikimet e të licencuarve për kostot e nevojshme dhe të jetë e bindur se propozimet e të licencuarve janë të arsyeshme. Baza ligjore i obligon të licencuarvit të ofrojnë të gjitha të dhënat e kërkuara nga ZRRE për qëllim të kryerjes së kësaj analize. Për këtë arsye, në qershor ZRRE është konsultuar me palët e interes lidhur me formularët që do të përdoren për të mbledhur të dhënat e këtij shqyrtimi tarifor. Pas konsultimit, të licencuarit kanë pasur 8 javë për të plotësuar formularët. Të licencuarit kanë dorëzuar formularët e tyre më 3 shtator. Të licencuarit nuk kanë sjellur formular të kompletuar. Rrjedhimisht ZRRE është takuar me të licencuarit për të qartësuar të dhënat e dorëzuara. ZRRE ka vlerësuar aplikacionet e KEK-ut me ndihmën e dy kompanive ndërkombëtare inzhinjerike. Vlerësimet fillestare të ZRRE-së janë dhënë më poshtë. Informata më të detajuara janë dhënë në Shtojcat (A deri në D) e këtij dokumenti.

### 2 Komente të Përgjithshme

Të dhënat e kërkuara nga ZRRE për qëllim të shqyrtimit shumë-vjeçar kanë qenë të detajuara lidhur me shpenzimet e viteve të kaluara dhe ato që propozohen për të ardhmen ZRRE e kupton që mungesa e përvojës së kompanive lidhur me kërkesat e ZRRE-së mund të ketë vështirësuar dorëzimin e të dhënave të kompletuara dhe të justifikuar. Pavarësisht takimeve të shumta në mes të ZRRE-së dhe kompanisë gjatë kësaj periudhe, disa pyetje të konsiderueshme mbesin ende të paqarta. Këto kryesisht kanë të bëjnë me:

- Mungesën e arsyeshmërisë së nevojshme për kostot e propozuara;
- Mospërputhjen e të dhënave me burimet e tjera të informacionit; dhe
- Ofrimin e informative mbështetëse dhe përmbledhjeve të nevojshme për të mbështetur parashikimet e kostove

Në mungesë të të dhënave mbështetëse, ZRRE mund të vendosë që disa prej elementeve të kostove janë të pajustificueshme dhe t'i përjashtojë nga llogaritjet e Të Hyrave Maksimale të Lejuara. Është e rëndësishme që i licencuari të marrë parasysh këtë dhe të qartësojë e të justifikojë të gjitha informatat e kërkuara nga ZRRE apo konsulentët e saj.

ZRRE poashtu thekson se ka korrelacion të dobët në mes të kostove të lejuara në shqyrtimet e kaluara tarifore dhe ato të paraqitura në SHTE7. ZRRE thekson se kjo mund të jetë pjesërisht si pasojë e mos-përputhjeve në mes të cikleve vjetore të raportimit por kjo megjithatë nuk e sqaron madhësinë e këtyre ndryshimeve. Këto mos-përputhje potenciale vështirësojnë përdorimin e të

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

dhënave historike operative për të parashikuar kostot potenciale në të kaluarën dhe është e rëndësishme që të licencuarit të sigurojnë që të dhënat e dorëzuara në ZRRE të jenë në përputhje me njëra tjetrën ose, në rastet kur ka mos-përputhje, t'i sqarojë ato.

### 3 Vlerësimi i Kostove të Divizionit të Gjenerimit dhe të Minierave të KEK-ut

Gjetjet kryesore të vlerësimit primar të Kostove Operative të Divizionit Minierave dhe të Gjenerimit të KEK-ut janë dhënë më poshtë:

- KEK-u nuk ka ofruar informata të mjaftueshme për llogaritjen e kostos së zhvlerësimit. Megjithatë KEK-u ka ofruar vlerat e saja të llogaritjes së zhvlerësimit të cilat, sipas gjykimit të ZRRE-së, janë bazuar në jetëgjatësitë e përdorura për qëllime të kontabilitetit. Për qëllim të llogaritjes së zhvlerësimit është e rëndësishme që të qartësohet qasja e KEK-ut për këtë llogaritje si dhe të dhënat e përdorura – rrjedhimisht propozimi i KEK-ut për zhvlerësim kërkon studim të mëtejshëm. KEK-u është njoftuar lidhur me këtë çështje më 11 shtator, megjithatë deri më tani ZRRE nuk ka marrë përgjigje të kënaqshme.
- KEK duhet të ofrojë sqarime lidhur me investimin prej 110 milionë eurosh në kuadër të projekteve ambientale për Kosovën B dhe që është i nevojshëm për përmbushjen e Direktivës LCP.
- Investimet operationale të propozuara nga KEK duken të arsyeshme. Megjithatë në mungesë të informatave të detajuara lidhur me karakteristikat teknike të këtyre investimeve të planifikuara është e vështirë të gjykohet nëse vlerësimet e kostove janë të justifikueshme.

#### 3.1 Shpenzimet Operative të Minierave

Kostot e stafit janë parashikuar të jenë prej €7000 deri në €8000 për të punësuar. KEK-u ka parashikuar që kostot e pagave të rriten për 5% për vit por, si në rastet e tjera, nuk ka ofruar të dhëna për të përkrahur këtë kërkesë..

Kostot e energjisë elektrike dhe të Shpenzimeve të Tjera kryesisht varen nga kostot e lëndës djegëse dhe, në masë më të vogël, nga kostot e ujit. KEK-u duhet të ofrojë ndarje më të detajuar të komponentave të kostove të kësaj kategorie për të lehtësuar vlerësimin e parashikimeve të tyre.

Kostot për materiale dhe për mirëmbajtje duhen sqaruar më tepër: kjo kategori kostosh ka variuar nga viti në vit dhe KEK-u nuk ka sqaruar pse.

#### 3.2 Shpenzimet Operative të Gjenerimit

Sasitë e thëngjillit të raportuara nga KEK-u janë në përputhje me sasitë e pritshme të përdorimit të thëngjillit që do të ishte i nevojshëm për të gjeneruar sasinë e planifikuar të energjisë elektrike. Megjithatë ekziston një ndryshim i konsiderueshëm në mes të prodhimit të thëngjillit dhe përdorimit

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

të tij për gjenerim të energjisë elektrike (Gjenerimi përdorë përafërsisht 5 milion tonë thëngjill ndërsa Minierat deklarojnë se Gjenerimit i shesin përafërsisht 7.8 milionë tonë). KEK-u duhet të sqarojë këtë.

Sa i përket lëndës djegëse (naftë dhe mazut) që përdoret në Kosovën A dhe Kosovën B, sasitë e raportuara janë përgjithësisht në përputhje me sqarimet e dhëna lidhur me operimin e impianteve energjetike. Megjithatë KEK-u duhet të ofrojë detaje të mëtutjeshme lidhur me nivelin e efijencës teknike të Kosovës A për të mbështetur analizën e tyre.

### 3.3 Shpenzimet Kapitale të Minierave

Të dhënat e dorëzuara nga KEK nuk kanë informata të mjaftueshme lidhur me natyrën dhe justifikimin e propozimeve të investimeve kapitale. Pa këto informata është e vështirë për ZRRE-në të lejojë mbulimin e kostove të pa mbështetura.

### 3.4 Shpenzimet Kapitale të Gjenerimit

Shpenzimet kapitale për Kosovën A dhe B mund të ndahen në dy kategori kryesore: investimet që ndihmojnë mbajtjen në funksion të impianteve dhe investimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit. Investimet operacionale të propozuara nga KEK-u duken të arsyeshme. Megjithatë, pa informata të detajuara lidhur me karakteristikat teknike të investimeve kapitale është e vështirë të vlerësohet nëse kostoja e tyre është e arsyeshme.

Sa i përket projektit ambiental për Kosovën B, KEK-u duhet të ofrojë sqarime rreth investimit prej 110 milionë eurosh që ka të bëjë me Direktivën LCP. Për të vlerësuar më tutje këtë investim, KEK-u duhet të ofrojë informata lidhur me emetimin e tanishëm dhe detaje për investimin e planifikuar capital.

KEK-u thotë se asnjë nga investimet kapitale të tanishme apo në të ardhmen nuk financohen nga grantet. KEK-u duhet të sqarojë se si pret t'i financojë këto projekte. Deri më tani, ZRRE nuk ka informata se KEK-u ka qenë në gjëndje të sigurojë financim komercial për investime kapitale. ZRRE duhet të bindet se KEK-u ka një strategji të duhur dhe të implementueshme për financimin e projekteve kapitale. Për më tepër, KEK-u duhet të theksojë gjëndjen e investimeve kapitale që janë planifikuar për vitin 2012 në mënyrë që këto të kuptohen në kontekst të shpënzimeve të parashikuara kapitale.

## 4 Vlerësimi i Shpenzimeve Kapitale të Divizionit të OSSH-së së KEK-ut

Gjetjet kryesore të shqyrtimit fillestar të ZRRE-së për shpenzimet kapitale të OSSH-së janë dhënë më poshtë.

### 4.1 Propozimet e shpenzimeve kapitale të Divizionit të OSSH-së së KEK-ut:

- Buxheti i shpenzimeve kapitale për periudhën 2013-2017 është 114.3 milionë euro
- Niveli i përgjithshëm i propozuar i investimeve kapitale vjetore është në mes të 22.3 milionë dhe 23.4 milionë euro në vit.

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

- Investimet totale që kanë të bëjnë me ngarkesën janë 46.3 milionë euro dhe këto përfshijnë 6.2 milionë euro të cilat janë bartur nga projektet e viteve 2011 dhe 2012
- Investimet totale që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën janë 44.8 milionë euro
- Investimet totale jo-operacionale janë 23.2 milionë euro
- Aplikacioni i dorëzuar është në përputhje me Planin Zhvillimor të Rrjetit 2012-2017.

### 4.2 Kostot e KEK-ut për njësi

Kostot e KEK-ut për njësi janë dhënë për një njësi të vetme apo kategorizim – në praktikë përdoret një numër më i madh i njësive apo kategorizimeve. ZRRE ka krahasuar kostot e propozuara për njësi të KEK-ut me ato të kompanive shpërndarëse që prokurojnë në tregun ndërkombëtar dhe të cilat kanë kosto të ngjashme të punëtorëve për instalim dhe komisionim. Kjo analizë sugjeron që kostot për njësi për linja mbitokësore të KEK-ut duket të jetë 20% deri në 30% më të larta se kompanitë e krahasuara – kjo vlen edhe për stabilimentet 10kV. Kostot për njësi për kabllot 400V duken të jenë rreth 50% më të larta se kompanitë e krahasuara.

KEK-u duhet të jetë në gjëndje të ofrojë kostot historike lidhur me koston mesatare të stabilimenteve të instaluar për të mbështetur argumentet e tyre. Pa justifikimet e nevojshme, do të jetë e vështirë për ZRRE-në të pranojë kostot për njësi të propozuara.

### 4.3 Modelimet e shpenzimeve që kanë të bëjnë me ngarkesën dhe të atyre që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën

ZRRE ka modeluar shpenzimet kapitale që kanë të bëjnë me ngarkesën dhe atyre që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën duke u bazuar në numrat e konsumatorëve të KEK-ut, parashikimin e kërkesës, kostot për njësi, vjetërsinë e aseteve dhe jetëgjatësinë e tyre. Analiza e ZRRE-së për shpenzimet që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën sygjerojnë që shpenzimet kapitale të nevojshme për periudhën 2013-2017 janë 140 milionë euro (krahasuar 45 milionë sa propozon KEK-u).

Model i investimeve kapitale që kanë të bëjnë me ngarkesën poashtu vlerëson se shpenzimet totale kapitale për periudhën 2013-2017 duhet të jenë mbi 140 milionë euro krahasuar me 45 milionë euro sa ka propozuar KEK-u.

Shpenzimet kapitale të KEK-ut duken të ulëta kur merren parasysh numri i konsumatorëve, parashikimi i kërkesës, kostot për njësi, vjetërsia e aseteve dhe jetëgjatësia e tyre. Megjithatë këto investime kapitale duken të jenë të njëjta me shpenzimet e 5 viteve të fundit dhe kjo mund të jetë si indikator i kufizimeve të burimeve njerëzore dhe kapitale në përgatitjen e parashikimeve. ZRRE pret që KEK-u të ketë plan afatgjatë për të adresuar vjetërsinë e aseteve pasi që ky plan 5-vjeçar nuk merr parasysh zëvendësimet dhe përforsimet e nevojshme që do t'i mundësonin KEK-ut t'ju afrohej praktikave të mira ndërkombëtare sa i përket gjendjes së rrjetit dhe performancës.

## 5 Shpenzimet Operative të OSSH-së së KEK-ut

KEK-u ka ofruar shumë pak informata për të mbështetur nivelin e kërkuar të kostove operative për periudhën e parashikuar. Pa mbështetjen dhe justifikimin e nevojshëm, do të jetë e vështirë për ZRRE-në të pranojë rritjet e parashikuara për kostot operative.

Posaçërisht nuk ka arsyeshmëri të nevojshme për të përkrahur rritjen prej 5% për vit në pagat e numrit konstant të stafit.

KEK-u ka ofruar një parashikim të vëllimeve të Mirëmbajtjeve dhe Riparimeve. Megjithatë, në mungesë të informative të kostove për njësi, është e vështirë të justifikohet propozimi i KEK-ut për rritje vjetore të këtyre shpenzimeve prej 4% në vit.

## 6 Kostot e FPPEE-së

Kostoja mesatare e shërbimit ndaj konsumatorëve në vitin 2012 është përafërsisht në linjë me *benchmark* analizën e bërë nga ZRRE-ja. Megjithatë, rritja e paraparë për vitet në vijim kryesisht vjen si pasojë e rritjes së kostos së pagave prej 5% për vit. Meqë KEK-u nuk ka paraparë rritje të numrit të stafit nga viti 2012 dhe meqë KEK-u nuk ka ofruar justifikim për rritje të agave për inflacion, mund të jetë e duhur që kostot bazë për paga të bazohen në nivelin e 2012.

Kostot Operative, të mirëmbajtjes dhe të tjera për konsumatorë nuk pritet të kenë rritje pa arsytim. Përveç nëse KEK-u ofron informata mbështetëse ZRRE do të bëjë vlerësimin e saj për nivelin e duhur të këtyre kostove.

## 7 Hapat e më tutjeshëm

KEK-u mund të komentojë në vlerësimet fillestare të ZRRE-së mbi aplikacionet e tyre dhe të ofrojë plotësime dhe justifikime për të përkrahur aplikacionin e tyre. Nëse nuk ofrohen justifikimet e nevojshme, ZRRE duhet të marrë qëndrimin e vet për nivelin e duhur të disa kostove.

Përgjigjet e KEK-ut duhet të dorëzohen para orarit të punës më 9 nëntor 2012.

Pas marrjes së përgjigjeve të KEK-ut në këtë dokument, ZRRE do të përgatisë Vlerësimet e Përkohshme të MAR-it për divizionet e licencuara që pritet t'i dërgohet kompanisë në fund të dhjetorit 2012. Në të njëjtën kohë, ZRRE do t'i dërgojë KEK-ut modelin e të hyrave që është zhvilluar për të përkrahur llogaritjen e MAR-it në pajtim me Rregullat e Çmimeve.

## Shtojca A

### Të dhënat e dorëzuara nga Divizionet e Minierave dhe të Gjenerimit të KEK-ut

#### 1 Hyrje

Kjo shtojcë paraqet vlerësimet e ZRRE-së të të dhënave të dorëzuara nga KEK-u në shqyrtimin shumëvjeçar më 31 gusht 2012 si dhe informatave të dhëna më vonë përmes takimeve me KEK-un.

#### 2 Të dhënat e ofruara nga KEK-u për minierat për periudhën 2013-2017

##### 2.1 Shpenzimet Operative të Minierave

###### 2.1.1 *Kostot e personelit*

Kostot fillestare të stafit janë parashikuar të jenë prej 7,000 deri në 8,000 euro për punonjës. KEK-u ka parashikuar rritje prej 5% të këtyre kostove dhe nuk ka ofruar sqarim lidhur me këtë 5% rritje vjetore.

###### 2.1.2 *Kostot e energjisë elektrike dhe e shpenzimeve të tjera*

Këto kosto kryesisht varen nga kostot e lëndës së parë dhe, në masë më të vogël, nga kostoja e ujit. KEK-u duhet të ofrojë ndarje shtesë lidhur me komponentet e këtyre kostove në këtë kategori për të mundësuar vlerësimin më të duhur të parashikimeve të tyre.

###### 2.1.3 *Kostot e materialit dhe ato të mirëmbajtjes*

Kostot për materiale dhe për mirëmbajtje duhen sqaruar më tepër: kjo kategori kostosh ka variuar nga viti në vit dhe KEK-u nuk ka sqaruar pse.

KEK-u nuk ka ofruar informata të mjaftueshme për llogaritjen e kostos së zhvlerësimit. Megjithatë KEK-u ka ofruar vlerat e llogaritjes së zhvlerësimit të cilat, sipas gjykimit të ZRRE-së, janë bazuar në jetëgjatësitë e përdorur për qëllime të kontabilitetit. Për qëllim të llogaritjes së zhvlerësimit është e rëndësishme që të qartësohet qasja e KEK-ut për këtë llogaritje si dhe të dhënat e përdorura – rrjedhimisht propozimi i KEK-ut për zhvlerësim kërkon studim të mëtejshëm. KEK-u është njoftuar lidhur me këtë çështje më 11 shtator, megjithatë deri më tani ZRRE nuk ka marrë përgjigje të kënaqshme.

## **2.2 Shpenzimet kapitale të Minierave**

Të dhënat e dorëzuara nga KEK-u nuk kanë informata të mjaftueshme lidhur me natyrën e investimeve apo nuk i justifikojnë projektet kapitale të propozuara. Në mungesë të këtyre justifikimeve do të jetë e vështirë për ZRRE-nën të lejojë kostot e planeve të pambështetura.

## **3 Të dhënat e ofruara nga KEK-u për minierat për periudhën 2013-2017**

### **3.1 Kostoja e lëndës së parë**

Sa i përket lëndës djegëse (naftë dhe mazut) që përdoret në Kosovën A dhe Kosovën B, sasitë e raportuara janë përgjithësisht në përputhje me sqarimet e dhëna lidhur me operimin e impianteve energjetike. Megjithatë KEK-u duhet të ofrojë detaje të mëtutjeshme lidhur me nivelin e efikasitetit teknike të Kosovës A për të mbështetur analizën e tyre.

### **3.2 Kostot operative dhe të mirëmbajtjes**

#### **3.2.1 Kostot e personelit**

Kostot e shpenzimeve të personelit duken të jenë në përputhje me vlerat e pritura për këto kosto. Megjithatë, pa justifikimet e nevojshëm mund të jetë e vështirë për ZRRE-në të pranojë parashikimet e KEK-ut për shpenzimet e personelit për periudhën rregullative.

#### **3.2.2 Shpenzimet e tjera (komunalitet)**

Kjo nësi kostoje përfshin blerjet e energjisë elektrike (për vitet 2008 dhe 2009), kostot e lëndës djegëse, kostot e ujit dhe kostot e transmissioinit të energjisë elektrike. Në të gjitha këto raste, KEK-u nuk ka ofruar sqarime të nevojshme lidhur me natyrën e këtyre kostove. KEK-u duhet të sqarojë nevojën për kosto në kategorinë “gaz dhe ujë” dhe t’i sqarojë mospërputhjet e dukshme të këtyre kostove në të dyja impiantet.

### **3.3 Shpenzimet Kapitale të Divizionit të Gjenerimit të KEK-ut**

Shpenzimet kapitale për Kosovën A dhe B mund të ndahen në dy kategori kryesore: investimet që ndihmojnë mbajtjen në funksion të impianteve dhe investimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit. Investimet operationale të propozuara nga KEK-u duken të arsyeshme. Megjithatë, pa informata të detajuara lidhur me karakteristikat teknike të investimeve kapitale është e vështirë të vlerësohet nëse kostoja e tyre është e arsyeshme.

Përveq kostove të mirëmbajtjes, një burim i madh i shpenzimeve kapitale ka të bëjë me projektet ambientale të Kosovës A:

- Precipitatori(Filtri) Elektrostatik në njësinë A4

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

- Përmirësimi ambiental për të qenë kompatibil me LCP Direktivën

Vlefshmëria e këtyre skemave si dhe kostoja që asocohet me to do të varet nga vendime më të gjera që kanë të bëjnë me investime në kapacitete të reja meqë këto kosto do të ndikojnë në operimin e ardhshëm dhe ekzistencën e Kosovës A. Nëse Kosova A dekomisionohet, KEK-u duhet të ofrojë strategjinë për mbulimin e kostove relevante.

Sa i përket projektit ambiental për Kosovën B, KEK duhet të japë një sqarim lidhur me projektin prej 110 milionë eurosh që është i nevojshëm për kompatibilitet me Direktivën LCP. Për të vlerësuar më tutje këtë projekt, KEK-u duhet të ofrojë informata të mëtutjeshme lidhur me emetimin e tanishëm si dhe detaje për investimet e planifikuara.

Për më tepër, KEK-u duhet të sqarojë statusin e investimeve kapitale për vitin 2012 në mënyrë që këto të kuptohen në kontekst të shpenzimeve të parashikuara kapitale.

## Shtojca B

### Dorëzimi i Shpenzimeve Kapitale të KEK OSSH

#### 1 Hyrje

Kjo Shtojcë paraqet vlerësimin fillestar të ZRRE të informatave të KEK-ut të ofruara në pyetësorin për tarifa shumëvjeçare të dorëzuara më 31 gusht 2012, takimet pasuese sqaruese dhe dokumentacionit shtesë të ofruar nga KEK-u deri më 13 tetor 2012.

#### 2 Metodologjia

Për vlerësimin e kërkesave për shpenzime kapitale, është kryer një vlerësim nga poshtë lartë dhe nga lartë poshtë.

Për vlerësimin nga poshtë lartë, ZRRE ka:

- Rishikuar dorëzimin e informatave kundrejt zhvillimit të rrjetit të ofruara nga KEK-u për periudhën përkatëse për të vlerësuar nëse informatat janë nxjerrë sipas procesit të planifikimit të investimeve të të licencuarit dhe nëse janë në pajtim me fushat e identifikuara nga i licencuari si fusha me prioritet.
- Rishikuar parashikimin e shpenzimeve kundrejt shpenzimeve historike. KEK-u nuk ka siguruar shpenzimet historike kapitale, kështu që ZRRE ka nxjerrë një shifër nga informatat për vjetërsinë e aseteve.
- Rishikuar, kostot njësi të përdorura nga KEK në zhvillimin e parashikimit të shpenzimeve kapitale për t'u siguruar se ato janë të arsyeshme.
- Përcaktuar parashikimet e shpenzimeve kapitale me kosto të rishikuara të njësive ku kostot e njësive të KEK-ut ishin më të larta se ç'pritej.

Parashikimi nga poshtë lartë i shpenzimeve kapitale i paraqitur më sipër është krahasuar me modelin nga lartë poshtë, i cili është i përbërë nga dy pjesë:

Modeli i shpenzimeve për zëvendësime që nuk lidhen me ngarkesë (SHNLN) që vlerëson kërkesat për zëvendësim të nxjerra nga parashikimi i zëvendësimit në bazë të vjetërsisë duke shfrytëzuar informatat e vjetërsisë së aseteve të KEK-ut dhe duke aplikuar shpërndarjen e Poissonit në jetëgjatësinë e asetit të KEK-ut për secilin lloj të asetit. Meqë KEK-u nuk ka ofruar jetëgjatësinë e pritur të aseteve të tij, ZRRE ka shfrytëzuar shifrat e ofruara nga Ofgem.

Modeli i shpenzimeve të lidhura me ngarkesën (SHLN) i cili identifikon ngritjet e mundshme të aseteve të nevojshme për të përmbushur rritjen e planifikuar të parashikuar nga bartësi i licencës.

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

Shpenzimet në këtë model me gjasë do të jenë më të larta sesa që pritet për Kosovën meqë bazohen në një rrjet që funksionon brenda parametrave normale të operimit, gjersa informatat e paraqitura për ngarkesën dhe rënien e tensionit janë të qarta që sistemi i shpërndarjes së KEK-ut është i mbingarkuar në masë të madhe.

Nga ky parashikim i rregulluar nga poshtë lartë i kostove të njërive dhe modeli i shpenzimeve nga lartë poshtë, ZRRE ka krijuar një pasqyrë fillestare lidhur me arsyeshmërinë e parashikimit të paraqitur nga KEK OSSH.

### 3 Dorëzimi i shpenzimeve kapitale i KEK-ut 2013-2017

Të dhënat e parashikimit të shpenzimeve kapitale të KEK OSSH përfshinin informata të konsiderueshme por projektet nuk janë kategorizuar në shtytësit kryesorë të lidhur me ngarkesën, që nuk lidhen me ngarkesën, që nuk janë operative, apo të cilësisë së furnizimit. ZRRE pret që një biznes efikas të jetë në gjendje t'i identifikojë shtytësit kryesorë të projektit dhe të përfshijë skema sipas titujve përkatës. ZRRE kategorizon projektet përmes interpretimit të titujve të projektit dhe përshkrimit të punëve në Planin e Zhvillimit të Rrjetit.

Informatat e mira të aseteve janë thelbësore për modelimin e kërkesave për zëvendësime, por tabelat e aseteve të paraqitura në dorëzim përmbanin informata shumë të kufizuara për asetet TU dhe në vlerësim ZRRE është dashur të supozojë vëllimin dhe vjetërsinë e shumicës së aseteve të tensionit të ulët bazuar në raportet standarde të aseteve të tjera të njohura dhe numrit të konsumatorëve. Gjithashtu, është thelbësore që asetet e paraqitura në profilin e vjetërsisë së aseteve të mos përfshijnë asete të vjetra të cilat janë hequr nga sistemi. Nuk është e qartë nëse procedurat e KEK-ut janë adekuate për të siguruar se kjo edhe ka ndodhur.

KEK-u nuk ka siguruar profil të shpenzimeve historike dhe ZRRE ka shfrytëzuar profilin e vjetërsisë së aseteve dhe informatat e kostove të njërive për t'i nxjerrë shpenzimet e modeluara historike kapitale në çmimet aktuale. Kjo nuk përfshin asnjë shpenzim jo-operativ dhe mund të përfshijë asetet që janë transferuar në KEK si pjesë e lidhjeve të konsumatorëve.

Dorëzimi i shpenzimeve kapitale i KEK-ut (fleta Excel DS6) përfshinte rrjedhat e kostove për periudhën 2013-2017 në çmimet e vitit 2012. Për të ndihmuar vlerësimin, ZRRE i ka grupuar ato sipas kategorive:

- Shpenzimet që lidhen me ngarkesën
- Shpenzimet që nuk lidhen me ngarkesën
- Shpenzimet jo-operative.

Gjithsej shpenzimet kapitale në të tri kategoritë janë € 114.3 milionë, të shpërndara njëtrajtshëm gjatë pesë viteve të MYT (d.m.th. ndërmjet € 22 dhe € 23 milionë për vit).

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

### 3.1 Shpenzimet që lidhen me ngarkesën

Shpenzimet e lidhur me kërkesën janë shpenzimet për asetet e reja për të përmbushur rritjen e ngarkesës në rrjet si rrjedhojë e lidhjeve të reja apo rritjes së shfrytëzimit të energjisë elektrike nga konsumatorët ekzistues. Shpenzimet e parashikuara gjatë periudhës 2013-2017 janë gjithsej € 46.3 milionë, që përfshijnë € 6.2 milionë për projektet e bartura nga viti 2012 duke përfshirë realizimin e plotë të tre nënstacioneve 35/10 kV. Pjesa tjetër e punëve prej € 40.1 milionë mbulon:

- Sigurimin e kapacitetit shtesë në nënstacionet 35/10 kV
- Largimin e “fytave të ngushtë” të linjave të mbingarkuara, kablllove dhe transformatorëve në 35 kV, 10 kV dhe TU. Rritja e kapacitetit të këtyre “fytave të ngushtë” apo anashkalimi i tyre me qarqe të reja mundëson kapacitetin e plotë të aseteve ekzistuese që do të shfrytëzohen.

### 3.2 Shpenzimet që nuk lidhen me ngarkesën

Shpenzimet që nuk lidhen me ngarkesën kryesisht ka për qëllim zëvendësimin e aseteve të vjetra. Gjatë periudhës 2013-2017 kjo shumë përbën € 44.8 milionë me të cilat mbulohet:

- Përforcimi i rrjetit (d.m.th. zëvendësimi i linjave 10 kV dhe TU dhe transformatorëve 10/0.4 kV) – ndonëse përforcimi i rrjetit është zakonisht shpenzim që lidhet me ngarkesën, punimet e kësaj pike janë identifikuar kryesisht si rindërtime.
- Zëvendësimi i linjave me gjatësi ajrore që përbëjnë rrezik të sigurisë

### 3.3 Shpenzimet jo-operative

Shpenzimet jo-operative për periudhën 2013-2017 janë gjithsej € 23.2 milionë të cilat mbulojnë:

- Programin e përmirësimeve të njehsimit vjetorë
- Zbatimi i sistemit të menaxhimit të shpërndarjes (DMS) dhe automatizimi i nënstacioneve në nivelin 35kV
- Elemente tjera të vogla, përfshirë një Qendër të reja të Dispeçingut

### 3.4 Vlerësimi sipas Planit Zhvillimor të Rrjetit

Shpenzimet kapitale të paraqitura në fletën Excel DS6 janë në përputhje me buxhetin e paraqitur në Tabelën 12 të Planit Zhvillimor të Rrjetit (PZHRR 2013-2017) që është paraqitur më poshtë në Tabelën 1. PZHRR 2013-17 paraqet kostot e detajuara për:

- i) Projektet kapitale të filluara më 2011 të bartura në vitin 2013 (€ 5.6 m)
- ii) Largimi/zëvendësimi i linjave me gjatësi ajrore të cilat paraqesin rrezik sigurie (€ 16.8 m)
- iii) Avancimi i shpërndarjes së mbingarkuar në linjat 35 kV dhe 10 kV (€ 17.8 m)
- iv) Avancimi i nënstacioneve të mbingarkuara 10/0.4 kV (€ 7.8 m)
- v) Avancimi i linjave të mbingarkuara 0.4 kV (€ 7.9 m)

Pikat ii) deri v) më lartë që janë prezantuar në hollësi në Shtojcën B të PZHRR 2013-17 janë mbledhur për secilin vit dhe buxhetet vjetore ishin në përputhje me shifrat e cituara në dorëzimin e shpenzimeve kapitale të KEK (DS6) për pikat 13 deri 16 në Tabelën 1. Rrjedha e gjashtë e kostove e

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

prezantuar në PZHRR 2013-17 për rishtrimin kablove 35 kV dhe 10 kV në kanalet me hapje për qasje (gjithsej kosto e përafërt prej €10.8 milionë) është lënë jashtë qëllimisht nga KEK për buxhetin e propozuar të shpenzimeve kapitale meqë KEK ka theksuar se ky nuk është prioritet.

Një rrjedhë shtesë e kostove që ka për synim 10 qarqet më të dobëta furnizuese në secilën nga shtatë zonat e Kosovës për trajtimin e problemeve siç janë mbingarkesat, siguria, mirëmbajtja dhe besueshmëria është realizuar në kuadër të Programit Vjetor për Përforcimin e Rrjetit. Programi 2013-14 vlerësohet se do të kushtojë €10.4 milionë.

### 3.5 Krahasimi me shpenzimet kapitale historike

KEK-u nuk ka paraqitur shpenzime kapitale historike në dorëzimin e tij. ZRRE ka modeluar shpenzimet historike bazuar në pikëpamjes së tij të kostove të njësive dhe profilit të vjetërsisë së aseteve të KEK-ut, me supozime për zëvendësimin e të dhënave që mungojnë. Kjo tregoi se gjithsej shpenzimi i përafërt për pesë vitet deri 2011 ishte €117m me investime mesatare vjetore prej €23.4m, kryesisht në pajtim me parashikimin e KEK-ut për vitin 2013-2017.

### 3.6 Kostot e njësive të KEK-ut

KEK-u ka paraqitur kostot e njësive të përdorura në Planin Zhvillimor të Rrjetit si të bazuara në çmimet e kontratave të fundit. ZRRE i ka krahasuar ato kundrejt kostove të raportuara nga ndërmarrjet tjera në shtetet në zhvillim të cilat bëjnë blerje në tregjet ndërkombëtare dhe kanë kosto relativisht të ulët të fuqisë punëtore vendore. Informatat e siguruar nga KEK-u për një element individual (p.sh. kablo 35 kV) është bazuar në një lloj dhe madhësi të vetme, ndonëse kostot e hollësishme të projekteve individuale tregojnë një gamë të tërë të llojeve dhe madhësive në përdorim me kosto të ndryshme. Modeli i ZRRE është bazuar në koston mesatare. Kjo mund t'i nënshtrohet rishikimit të mëtejshëm nëse KEK-u është në gjendje të ofrojë dëshmi të kostove të fundit dhe ponderim të përshtatshëm të madhësisë së aseteve të tyre.

*Nëse do të shfrytëzoheshin kostot e njësive të ZRRE në vend të atyre të KEK-ut, parashikimi i përgjithshëm i shpenzimeve kapitale do të ulej për 4-5%.*

Ky model shfrytëzon rritjen e numrit të konsumatorëve si shtytësin kryesor për parashikimin e kërkesave shtesë të aseteve. Kjo supozon që të gjitha parashikimet e konsumatorëve janë të reja në rrjet. KEK ka cekur se një pjesë e rritjes historike të konsumatorëve ishte si rrjedhojë e “normalizimit” të furnizimeve ekzistuese (instalimi i njehsorëve), megjithatë, nuk është e qartë nëse një pjesë e parashikimeve të konsumatorëve përfshin edhe elementin e “normalizimit”. Gjithashtu, modeli supozon që sistemi ekzistues operon në një gjendje të vazhdueshme në kuptim të ngarkesës së rrjetit.

### 4 Gjetjet

Kërkesa e dorëzuar për shpenzime kapitale është nxjerrë nga Plani Zhvillimor i Rrjetit dhe duket që projektet janë bazuar në kërkesat e rrjetit dhe prioritetet e KEK-ut. Bazuar në këtë, mund të jetë e arsyeshme që të pranohet fushëveprimi i programit të propozuar të shpenzimeve kapitale të KEK-ut, duke pranuar që rrjeti historikisht ka operuar në standard më të ulët dhe se kjo situatë mund të vazhdojë për një kohë në të ardhmen. Buxheti për shpenzime kapitale që ka propozuar KEK në dorëzimin përkatës dhe kostot tjera të identifikuar në Planin Zhvillimor të Rrjetit (por që nuk janë përfshirë në dorëzim) nuk korrespondojnë me nivelin e kostove të cilat ZRRE do të priste nga modeli i SHNLN dhe SHLN bazuar në përvojën nga rrjetet e zhvilluar në vende tjera. Kjo mund të tregojë që parashikimi i dorëzuar i shpenzimeve kapitale të KEK-ut është i kufizuar për nga resurset, apo që pasqyron një vazhdimësi të kufizimeve të shpenzimeve në vitet e fundit që nuk ka ndjekur hapin e kërkesave të performancës.

Vlerësimi i kostove të njësive tregon që disa kosto të njësive janë më të larta se që pritej. Shfrytëzimi i pikëpamjes e ZRRE për kostot e njësive jep ulje prej 4-5% të gjithsej shpenzimeve krahasuar me parashikimin e KEK-ut.

Mbesin disa pyetje të papërgjigjura për kostot e njësive dhe KEK-u duhet të ofrojë informata shtesë për të mbështetur propozimet e tij.

## Shtojca C

# Vlerësimi i shpenzimeve operative të KEK OSSH

## 1 Hyrje

Ky dokument paraqet vlerësimin e ZRRE të informatave të dorëzuara nga KEK në pyetësin për tarifa shumëvjeçare më 31 gusht 2012 dhe takimet pasuese sqaruese dhe dokumentacionin shtesë të ofruar nga KEK. Më saktësisht, ky dokument ka të bëjë me shpenzimet operative të KEK OSSH

Të dhënat burimore të KEK-ut janë paraqitur në formularin në format Excel me titull *“Formularët Raportues 2013-2017 14 09 2012.xls”*.

Përbrenda këtij dokumenti pune në Excel, në analizë janë shfrytëzuar të dhënat e shpenzimeve të fletëve *“DS1 Opex (DSOa) KEK”* dhe *“DS3 Other (DSO) KEK”*.

Kategoritë kryesore të shpenzimeve operative të KEK OSSH janë:

- Shpenzimet për paga (përfshirë pensionet dhe pagesat tjera të lidhura me pagat për stafin)
- Shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparime (përfshirë materialet e furnizuara)
- Shpenzimet tjera operative (shërbime të transportit dhe shpenzime të tjera), por duke përjashtuar shpenzimet që lidhen me Sigurime, Pagesa për Licenca dhe Zhvlerësim të cilat zakonisht barten në kosto.

## 2 Metodologjia

Një teknikë që përdoret rregullisht për të vlerësuar shpenzimet operative të një kompanie është që të krahasohen ato me shpenzimet e kompanive të ngjashme në vende të tjera. Në mungesë të të dhënave të shpenzimeve për kompanitë në rajon, ZRRE ka përdorur informatat për kompanitë në Lindje të Mesme, për qëllime të krahasimit.

Kjo analizë paraqiti një shpërhapje të gjerë të shpenzimeve për aktivitetet e kompanive krahasuese, madje edhe pas normalizimit të shpenzimeve për të përfshirë dallimet në topologjinë e rrjetit, densitetin e konsumatorëve, etj. Një gjë e tillë e ka vështirësuar nxjerrjen e konkluzave lidhur me arsyeshmërinë e shpenzimeve operative të KEK-ut për të bërë vlerësim të përmbushjes së standardeve.

Si rrjedhojë e kufizimeve në analizën e vlerësimit të përmbushjes së standardeve është konsideruar se është më mirë të kryhet një vlerësim i hollësishëm i niveleve të shpenzimeve operative të KEK-ut për periudhën 2008 deri 2017. Kjo analizë krahason shpenzimet historike kundrejt atyre të

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

parashikuara dhe mundëson arritjen e një gjykimi të arsyeshmërisë të lëvizjeve të shpenzimeve në të ardhmen.

### 3 Analizë e shpenzimeve operative të KEK OSSH

Shpenzimet operative janë siguruar nga KEK për periudhën 2008 deri 2017. Është supozuar se shpenzimet e periudhës 2008 -2011 janë në vlera nominale (shpenzimet aktuale) gjersa kostot e periudhës 2012 deri 2017 është supozuar se janë në terme reale (çmimet e 2012). Për qëllime të analizimit të këtyre shpenzimeve, shpenzimet e periudhës 2008 - 2011 janë rregulluar nga CPI sipas çmimeve të vitit 2012.

Tabela 1 më poshtë paraqet një analizë të shpenzimeve aktuale dhe të parashikuara kundrejt secilës kategori kryesore të shpenzimeve.


**Tabela 1 – Shpenzimet për paga në KEK (çmimet e 2012) - €'000**

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>Staff Costs</b>										
Salaries (net)	8,756	12,366	4,552	6,822						
Pension contribution and taxes	1,661	2,037	795	1,199	6,595	6,925	7,271	7,635	8,017	8,417
Other	131	159	206	90						
<b>Salary costs - total - Actual</b>	<b>10,549</b>	<b>14,562</b>	<b>5,554</b>	<b>8,111</b>	<b>6,595</b>					
<b>Salary costs - total - Forecast</b>						<b>6,925</b>	<b>7,271</b>	<b>7,635</b>	<b>8,017</b>	<b>8,417</b>
<b>Maintenance</b>										
Repairs Service	1,625	2,314	1,677	-						
Maintenance Service	275	41	56	1,906	4,905	5,101	5,305	5,517	5,738	5,968
Materials and Supplies	2,545	3,133	4,253	6,280						
<b>O &amp; M Costs - Actual</b>	<b>4,444</b>	<b>5,487</b>	<b>5,985</b>	<b>8,185</b>	<b>4,905</b>					
<b>O &amp; M Costs - Forecast</b>						<b>5,101</b>	<b>5,305</b>	<b>5,517</b>	<b>5,738</b>	<b>5,968</b>
<b>Other Operating Expense</b>										
Transport Services	395	441	304	194		201	210	217	224	228
Other Expenses	1,064	2,567	166	1,094	1,420	1,497	1,560	1,612	1,666	1,694
<b>Other Costs - Actual</b>	<b>1,459</b>	<b>3,007</b>	<b>138</b>	<b>1,289</b>	<b>1,420</b>					
<b>Other Costs - Forecast</b>						<b>1,698</b>	<b>1,770</b>	<b>1,829</b>	<b>1,891</b>	<b>1,922</b>
<b>Internal Expense</b>										
Cost of Coal from Mining	-	-	-	-						
Cost of Electricity and Distribution Services	-	-	-	-						
<b>Total costs - Actual</b>	<b>24,282</b>	<b>31,451</b>	<b>20,129</b>	<b>23,704</b>	<b>20,332</b>					
<b>Total costs - Forecast</b>						<b>22,321</b>	<b>23,831</b>	<b>25,363</b>	<b>26,778</b>	<b>28,253</b>

Secila nga kategoritë kryesore të shpenzimeve (shpenzimet për paga, mirëmbajtje dhe të tjera) janë analizuar në më shumë hollësi – profili i shpenzimeve të Pagave është përfshirë në Figurën 1 më poshtë.

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

Figura 1 Shpenzimet për paga në KEK – Çmimet e vitit 2012




Lëvizjet në nivele të pagave janë ndikuar nga dy faktorë. Në vitin 2009 pagat duken të larta si pasojë e përfshirjes së stafit të biznesit të furnizimit në numrat e stafit të shpërndarjes, duke paraqitur shpenzime jashtëzakonisht të larta. Faktori i dytë është transferimi i aseteve 110 kV dhe stafit përkatës nga KEK në KOSTT më 1 prill 2012. Shpenzimet për paga gjatë periudhës 2013 – 2017 kanë parashikuar rritje nga €7.4 milionë krahasuar me €6.8 milionë për vitet e mëparshme, gjegjësisht 2010 dhe 2011. Kjo paraqet një rritje në vlera reale prej 9.4%. Kjo rritje është kryesisht si pasojë e rritjes së parashikimit më 2012 prej 5% për vit mbi inflacionin.

KEK-u nuk ka siguruar asnjë arsyeshmëri për rritjen 5% mbi inflacion, posaçërisht meqë numrat e stafit janë të qëndrueshme nga viti 2012. Si rrjedhojë, mbajtja e nivelit shpenzimeve për paga të vitit 2012 në terme reale duket i arsyeshëm përveç nëse KEK mund të ofrojë arsyet mbështetëse për rritjet mbi inflacionin.

Figura 2 më poshtë paraqet një profil të shpenzimeve operative të KEK-ut për Riparime dhe Mirëmbajtje

Figura 2 Shpenzimet për mirëmbajtje në KEK – Çmimet e 2012



Parashikimet tregojnë rritje prej 4% prej viti në vit nga shpenzimet e lejuara për vitin 2012.

Është dëshmuar të jetë e vështirë të kuptohet natyra dhe niveli i aktiviteteve të Riparimeve dhe Mirëmbajtjes në KEK meqë informatat janë ofruar vetëm në bazë të llogarive financiare të KEK-ut, e jo shpenzimet në bazë të aktiviteteve nga departamentet e inxhinierisë në KEK. Ne presim që një kompani efikas të ketë informata më të plota dhe të ndara në kategori përkatëse të aktiviteteve të Riparimeve dhe Mirëmbajtjes për menaxhimin e resurseve të saj, dhe për planifikim më efektiv në të ardhmen. Prandaj, është veçanërisht zhgënjyese që KEK-u ka ofruar hollësi të kufizuara të shpenzimeve të aktiviteteve të tyre. Megjithatë, disa analiza të R&M kanë qenë të mundura përmes shfrytëzimit të të dhënave të dorëzuara nga KEK-u. Kjo tregon që shpenzimet e vitit 2012 janë bazë e mirëfilltët për vlerësimin e shpenzimeve të ardhshme. Veç kësaj, ZRRE ka analizuar trendet në vëllimet R&M për të përcaktuar shpenzimet e mundshme efektive operative. Rezultatet janë paraqitur në Tabelën 2 më poshtë.

Kostot e njësive për secilin aktivitet R&M nuk janë në dispozicion nga sistemet aktuale të kontabilitetit në KEK dhe nevojiten informata shtesë nga KEK lidhur me shpenzimet dhe aktivitetet e realizuara për secilën detyrë, në mënyrë që të mundësohen analiza të mëtejme kuantitative të lejimit. Siç është prezantuar, ato nuk mbështesin rritjen prej 4% në vit. Megjithatë, është e qartë se disa shpenzime shtesë për R&M janë të nevojshme. Për shembull, KEK-u ka identifikuar një program shtesë për prerjen e drunjëve, megjithatë, meqë këto janë shpenzime që kryesisht lidhen me fuqinë punëtore nuk është e qartë se cilat shpenzime do të pasqyrohen në R&M. Prandaj, është propozuar

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

që të lejohen shpenzimet e vitit 2012 gjatë periudhës 5 vjeçare përveç nëse KEK-u mund të ofrojë shpjegime për shpenzimet e pritura, që nuk lidhen me pagat, për secilën nga detyrat e identifikuara.

**Tabela 2 – Aktivitet R&M të Shpërndarjes së KEK-ut – krahasim i vëllimeve aktuale dhe të parashikuara**

Maintenance Activity	2008-2012 Average	2013-2017 Average	Variance Analysis	Response Provided by KEK
Replacement of switch-breaker-breaker power 35kV	5.6	5.2	-7.1%	KEK's practice has been to capitalize each cubicle (position) in a substation. In the event that a single component is repaired or replaced, the cost is charged to maintenance.
Replacement of switch-breaker power 10kV	39.2	41.0	4.6%	
Replacement of switch-breaker power 0.4 kV	74.4	73.4	-1.3%	
Repair of switch-breaker power 35 kV	5.2	5.6	7.7%	See response above. The 7.7% increase is because the 35kV circuit breakers are of high importance because their failure will leave considerable number of customers without electricity.
Repair of switch-breaker power 10 kV	23.2	11.2	-51.7%	
Protection check in TS 35/10 kV	117.8	93.2	-20.9%	
Replacement of seperators 10 kV	11.2	10.0	-10.7%	
Replacement of Isolators 35 kV (piece)	44.0	21.8	-50.5%	
Replacement of Isolators 10kV (piece)	2930.2	3120.0	6.5%	The existing insulators are aged and need periodic replacement
Replacement of Isolators 0.4 kV (piece)	7083.4	7260.0	2.5%	
Construction of cable connection 10 kV (piece)	553.4	636.0	14.9%	This activity is not capital project related. This activity is associated with repairs/replacement of the damaged/failed underground cables. Usually it is part of the O&M budget. The existing cable splices are old and require repair. Does this justify a 15% increase in activity?
Construction of cable connection 4 kV (piece)	130.4	129.4	-0.8%	
Construction of cable heads 35 kV (piece)	12.2	6.6	-45.9%	
Construction of cable heads 10 kV (piece)	146.2	182.8	25.0%	This activity is not capital project related. This activity is associated with repairs/replacement of the damaged/failed underground cables. Usually it is part of the O&M budget. Most of the underground cables are not equipped with proper cable heads and repairs are needed to prevent sudden failures. Is the failure rate increasing to suggest a 25% increase is realistic?
Replacement of poles 12m for 10 kV (piece)	1463.2	1830.0	25.1%	Some existing 12m poles are aged and in poor condition. KEK's practice has been to charge the cost of replacing just a few poles on a line to maintenance.
Replacement of poles 9m (piece)	3461.2	2832.0	-18.2%	
Cleaning of track for LP 35kV and 10 kV (km)	136.4	184.0	34.9%	This activity is to cut/remove trees and vegetation from the overhead lines in order to ensure the public safety and prevent line defects and short circuits. The above increase is because KEK is trying to reduce unforeseen outages.
Cleaning of track for LP 0.04 kV (km)	170.9	252.8	47.9%	This activity is to cut/remove trees and vegetables from the overhead lines in order to ensure the public safety and prevent line defects and short circuits. The above increase is because up to now activities were more focused in cleaning the track of the MV overhead lines. The future activities will focus more in LV network.
Replacement of conductors AlFe in LP 10 kV (kg)	13316.6	12500.0	-6.1%	
Replacement of conductors AlFe in LP 0.4kV (kg)	18100.8	18360.0	1.4%	
Replacement of cables 10 kV (m)	16850.8	16180.0	-4.0%	
Replacement of cable 0.4 kV (m)	41135.0	34060.0	-17.2%	
Oil check in TS 10/0.4 kV	690.0	128.0	-81.4%	
Protection check in TS 10/0.4 kV	335.2	344.0	2.6%	
Replacement of surge switch-breaker 10 kV (piece)	126.2	151.2	19.8%	This activity is related to surge arrestors installed in 10/0.4kV transformer stations. The existing surge arrestors installed at SS 10/0.4kV are aged and failing.


Ekziston një mospërputhje e madhe dhe ende e pashpjeguar për shumicën prej aktiviteteve, por nuk ka mbështetje bindëse për rritjen e propozuar të KEK-ut prej 4% për vit në shpenzimet e

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

përgjithshme të R&M. Përveç nëse KEK vendos të ofrojë dëshmi shtesë për të mbështetur këtë kërkesë, ZRRE mund të konkludojë se nivelet aktuale (2012) të shpenzimeve R&M do të vazhdojnë të jenë të përshtatshme për periudhën e parashikuar.

Figura 3 më poshtë paraqet një profil të shpenzimeve operative të KEK-ut që kanë të bëjnë me kategorinë e shpenzimeve të "Tjera".

**Figura 3 Shpenzimet operative të KEK-ut– Shpenzimet "tjera"**



Shpenzimet e parashikuara operative të KEK-ut për periudhën 2012 deri 2017 janë 19% më të larta sesa në periudhën 4 vjeçare 2008 deri 2011. Kjo është rritje e konsiderueshme në shpenzime dhe KEK duhet të ofrojë arsyeshmëri shtesë. Pa shpjegime shtesë, është vështirë që ZRRE të pranojë një rritje kaq të madhe.

## Shtojca D

# Vlerësimi i shpenzimeve operative të KEK PES

## 1 Hyrje

Kjo Shtojcë paraqet vlerësimin e ZRRE të informatave të dorëzuara nga KEK në pyetësin për tarifa shumëvjeçare më 31 gusht 2012 dhe takimet pasuese sqaruese dhe dokumentacionin shtesë të ofruar nga KEK. Më saktësisht, ky dokument ka të bëjë me shpenzimet operative të KEK PES

Të dhënat burimore të KEK-ut janë paraqitur në formularin në format Excel me titull *“Formularët Raportues 2013-2017 14 09 2012.xls*.

Përbrenda këtij dokumenti pune në Excel, në analizë janë shfrytëzuar të dhënat e shpenzimeve të fletës *PS2a Other PES KEK*”.

Kategoritë kryesore të shpenzimeve operative të KEK OSSH janë:

- Shpenzimet për paga (përfshirë pensionet dhe pagesat tjera të lidhura me pagat për stafin)
- Shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparime (përfshirë materialet e furnizuara)
- Shpenzimet tjera operative (shërbime të transportit dhe shpenzime të tjera).

Kjo analizë e shpenzimeve nuk përfshin elementet që kanë të bëjnë me Sigurime, Pagesa për Licenca dhe Zhvlerësim krahas shpenzimeve për blerje të energjisë elektrike, transmision, këmbime të energjisë elektrike, lëndë djegëse, gaz dhe ujë të cilat zakonisht barten në kosto.

## 2 Metodologjia

Një teknikë që përdoret rregullisht për të vlerësuar shpenzimet operative të një kompanie është që të krahasohen ato me shpenzimet e kompanive të ngjashme në vende të tjera duke shfrytëzuar një faktor normalizues bazuar në shtytësit kryesorë specifikë të kompanisë të shpenzimeve (d.m.th. numrat e konsumatorëve në rastin e biznesit të furnizimit).

Për të kryer ushtrimin e vlerësimit krahasues sipas standardeve me saktësi, janë të nevojshme të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme. Të dhënat nga kompanitë e vendeve fqinje të Furnizimit në Evropën Lindore/Ballkan nuk janë në dispozicion publik prandaj edhe krahasimi i të dhënave është bërë me ato të kompanive të furnizimit në Mbretërinë e Bashkuar. Ushtrimi i krahasimit është kryer duke pasur parasysh shpenzimet të kompanive së furnizimit të energjisë elektrike në MB kur këto kompani janë privatizuar së fundi dhe nuk i janë nënshtruar çrregullimeve të shpenzimeve nga futja e konkurrencës në pakicë.

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

Për qëllime të ushtrimit të krahasimit, është mirë të shfrytëzohen të dhëna aktuale të shpenzimeve operative sesa të parashikuara dhe prandaj analiza e krahasimit është kryer me anë të të dhënave të KEK-ut për vitin 2010.

Në të dhënat krahasuese të MB-së është përdorur inflacioni në çmime të vitit 2010 duke shfrytëzuar indeksin e çmimeve të pakicës në MB.

Analiza jonë identifikon një përhapje të shpenzimeve të krahasuara për konsumatorë dhe krahason ato standarde me shpenzimet e KEK PES për konsumatorë.

Përveç ofrimit të komenteve në analizën e krahasimeve, ky raport gjithashtu ofron edhe komente lidhur me lëvizjet në shpenzimet operative të KEK OSSH gjatë periudhës 2012 deri 2017.

### 3 Analiza e shpenzimeve operative të KEK PES

Shpenzimet operative janë siguruar nga KEK për periudhën 2008 deri 2017. Për qëllime të analizës së këtyre shpenzimeve, shpenzimet e periudhës 2008 - 2011 janë rregulluar nga CPI sipas çmimeve të vitit 2012.

Tabela 1 më poshtë paraqet një analizë të shpenzimeve aktuale dhe të parashikuara kundrejt secilës nga kategoritë kryesore të shpenzimeve.

**Tabela 2 – Shpenzimet e KEK PES (Çmimet e 2012) - €'000**

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Staff Costs										
Salaries (net)	1,913	432	9,505	8,529	7,935	8,332	8,749			
Pension contribution and taxes	342	76	3,586	3,476				9,186	9,645	10,128
Other	6	6	147	9						
Salary costs - total - Actual	2,260	513	11,238	10,014	7,935					
Salary costs - total - Forecast						8,332	8,749	9,186	9,645	10,128
Maintenance										
Repairs Service	26	166	90	-	-	-	-	-	-	-
Maintenance Service	38	6	25	298	282	296	309	319	330	335
Materials and Supplies	108	208	553	575	310	326	339	351	363	369
O&M costs - total - Actual	172	380	667	873	592					
O&M costs - total - Forecast						622	648	670	692	704
Other Operating Expense										
Transport Services	75	69	176	110						
HQ allocation from 2012 to 2017					1,871	1,800	1,915	2,032	1,988	2,027
Other Expenses	189	682	3,556	3,470	1,640	1,723	1,796	1,856	1,918	1,950
Other costs - total - Actual	264	751	3,732	3,580	3,511					
Other costs - total - Forecast						3,523	3,711	3,888	3,905	3,977
Internal Expense										
Cost of Coal from Mining	-	-	-	-						
Cost of Electricity and Distribution Services	116,341	148,292	122,693	131,243						
Total costs - Actual	119,037	149,935	138,331	143,711	12,039					
Total costs - Forecast						12,477	13,108	13,744	14,243	14,808

Shënim- tabela më lartë nuk përfshin: Sigurimet, Pagesat për Licenca dhe Zhvlerësim të cilat zakonisht barten në kosto, krahas shpenzimeve për blerje të energjisë, transmision, këmbim të energjisë, lëndë djegëse, gaz dhe ujë .

Të dhënat krahasuese në dispozicion nga kompanitë e furnizimit të MB-së tregojnë se baza e shpenzimeve të KEK PES për 2012 është në pajtim me shpenzimet e parashikuara të një kompanie të furnizimit me bazë të konsumatorëve prej 450,000 pas rregullimeve përkatëse për shpenzime

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut

mesatare të pagave dhe Paritetit së Blerjes së Energjisë *Purchasing Power Parity (PPP)* ndërmjet MB-së dhe Kosovës.

Variacionet e secilës nga kategoritë kryesore të parashikimeve (pagat, mirëmbajtja dhe shpenzime tjera) janë analizuar në më shumë hollësi në tabelën më poshtë.

**Tabela 2 – Shpenzimet e KEK PES për konsumator dhe punonjës (Çmimet 2012) - €'000**

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Staff Numbers	155	75	1,310	1,684	1,272	1,272	1,272	1,272	1,272	1,272
Customer numbers (ooo's)	383	401	422	442	449	462	476	491	505	520
Salary cost per employee (€'ooo)	14.58	6.84	8.58	5.95	6.24	6.55	6.88	7.22	7.58	7.96
					% Change	5.0%	5.0%	5.0%	5.0%	5.0%
Costs per customer (€'ooo)										
Salary Costs	5.90	1.28	26.61	22.67	17.68	18.02	18.37	18.73	19.09	19.46
					% Change	1.9%	1.9%	1.9%	1.9%	1.9%
O&M Costs	0.45	0.95	1.58	1.98	1.32	1.35	1.36	1.37	1.37	1.35
					% Change	2.0%	1.2%	0.3%	0.3%	-1.3%
Other operating expenses	0.69	1.87	8.83	3.58	7.82	7.62	7.79	7.93	7.73	7.64
					% Change	-2.6%	2.3%	1.7%	-2.5%	-1.1%
Salary+O&M+Other	7.04	4.10	37.02	28.22	26.82	26.98	27.52	28.02	28.19	28.45
					% Change	0.6%	2.0%	1.8%	0.6%	0.9%

Në periudhën ndërmjet 2012 dhe 2013 numrat e stafit mbesin konstante gjersa numri i konsumatorëve rritet për 3%.

Shpenzimet operative ndërmjet 2012 dhe 2013 ndryshojnë si në vijim:

- Rritje e shpenzimeve për paga për 5.0% për punonjës dhe 1.9% për konsumator
- Rritje e shpenzimeve të O&M për 2.0% për konsumator
- Ulje e shpenzimeve tjera operative për 2.6% për konsumator

Gjithsejt rritje shpenzimeve (pagat plus O&M plus të tjera) për 0.6% për konsumator.

Numri i stafit për periudhën ndërmjet viteve 2012- 2017 mbesin konstant gjersa numri i konsumatorëve rritet për 16%.

Shpenzimet operative ndërmjet 2012 dhe 2017 ndryshojnë si në vijim:

- Rritje e shpenzimeve për paga për 27.6% për punonjës dhe 10% për konsumator
- Rritje e shpenzimeve të O&M për 2.5% për konsumator
- Ulje e shpenzimeve tjera operative për 2.3% për konsumator

Gjithsejt rritje e shpenzimeve (paga +O&M+të tjera) për 6.1% për konsumator

Rritja e shpenzimeve mesatare për konsumator është kryesisht si pasojë e rritjes së pagave vjetore për 5% në vit për punonjës. Për sa i përket pjesëve tjera të biznesit të KEK-ut, është vështirë të mbështetet kjo shkallë e rritjes pa arsytim të mëtejshëm nga kompania.